



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONKURSI KOMBËTAR TEATRORE RINOR

Tiranë më , 19.04.2024

Drejtuar: **Fakultetit të Artit Skenik , Universiteti i Arteve Tiranë**

Lënda: Mundësi aktivizimi për studentët e Fakultetit të Artit Skenik

Përshëndetje,

Duke shpresuar të jeni mirë, ju informojmë se Konkursi Kombëtar Teatror nis rrugëtimin e tij në muajin Maj 2024 dhe mbyll edicionin e parë në muajin Dhjetor 2024.

Konkursi Kombëtar Teatror Rinor, është festivali që organizohet në formën e një kompeticioni , konkursi mes gjimnazeve të Republikës së Shqipërisë, me mbështetje të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit në bashkëpunim me bashkitë e qyteteve.

Në kuadër të paktit që ka Universiteti i Arteve, me Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit ju bëjmë me dije se dëshirojmë të përzgjedhim disa studentë nga viti i parë bachelor deri në vitin e dytë master për t'i angazhuar në Konkursin Kombëtar Teatror Rinor, nga të gjitha degët e studimit.

Lutem, që të informoni studentët nëpërmjet adresave të postës elektronike për këtë mundësi.

Studentët kanë të drejtë të aplikojnë deri në datën 25.04.2024 ora 16:30 duke dërguar materialet e mëposhtme në adresën e e-mail : hoxhalliermes25@gmail.com me subjekt “Për aplikim për Konkursin Kombëtar Teatror Rinor” .

1. Vërtetim nga Fakulteti i Artit Skenik që jeni student/e në Fakultetin e Artit Skenik ;
2. CV e nënshkruar ;
3. Letër reference nga dy individë të fushës së artit ;
4. Deklarimin ose vërtetim të gjendjes gjyqësore ;
5. Deklarim të konfliktit të interesit ;
6. Letër shprehje interesi ;

Studentët që do të përzgjidhen , do të njoftohen me anë të postës elektronike. Studentët e përzgjedhur do të paguhën honorar për detyrën që do i caktohet në ditë të caktuara.